

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikaplan® SGmA-12

MEMBRANË POLIMERE PËR HIDROIZOLIMIN E TARRACAVE ME BALAST



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikaplan® SGmA-12 është membranë sintetike me shumë shtresa për hidroizolim të tarracave me bazë polivinilkloridi (PVC) të cilësisë së lartë, e përforcuar me pëlhurë të pathurur me fibra qelqi sipas EN 13956.

PËRDORIMET

Membranë hidroizolimi për tarracat me balast (p.sh. zhavorr, pllaka betoni, tarraca të gjelbra (intensive, extensive), tarraca me qarkullim këmbësorësh):

- Shtrim i lirë me balast
- Tarraca të gjelbra
- Tarraca në përdorim

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Qëndrueshmëri e lartë përmasash për shkak të pëlhurës me fibra qelqi
- Përshkueshmëri e lartë e avujve të ujit
- Rezistencë ndaj të gjitha ndikimeve të zakonshme të mjedisit
- Rezistencë ndaj ndikimeve mekanike
- Rezistencë ndaj mikroorganizmave
- Rezistencë ndaj depërtimit të rrënjëve
- Saldim me ajër të nxehtë, pa përdorim zjarri
- I krijuar posaçërisht për aplikime poshtë pllakave të betonit, plantatorëve, themeleve, ballkoneve, tarracave dhe me metodën e pllakës së dyfishtë të betonit (split slab).
- I riciklueshëm

MIRATIME / STANDARDE

- Membranë polimere për hidroizolim tarrace sipas EN 13956, certifikuar nga organi i njoftuar 1213-CPD-4125 dhe mbart markën CE.
- Reagimi ndaj zjarrit sipas EN 13501-1.
- Rezistencë ndaj depërtimit të rrënjëve sipas procedurës së testimit FLL.
- Miratime zyrtare të Cilësisë dhe Certifikata Marrëveshjeje dhe miratime.
- Monitorim dhe vlerësim nga laboratorë të miratuar.
- Sistem i Menaxhimit të Cilësisë sipas EN ISO 9001/14001.
- Prodhuar sipas politikës Responsible Care të industrisë kimike.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Ambalazhi

Gjatësi ruloni:	20.00 m
Gjerësi ruloni:	2.00 m
Peshë ruloni:	60.00 kg

Paraqitja / Ngjyra	Sipërfaqja:	lehtësisht e strukturuar
	Ngjyra e sipërfaqes së sipërme:	bezhë
	Ngjyra e sipërfaqes së poshtme:	bezhë
Jetëgjatësia	5 vjet nga data e prodhimit në ambalazhin original, të pahapur dhe të padëmtuar.	
Kushtet e magazinimit	Rulonat duhet të ruhen midis +5°C dhe +30°C në pozicion horizontal në paletë, të mbrojtur nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor, shiu dhe dëbora. Mos vendosni paletat me rulona njëra mbi tjetrën apo materiale të tjera mbi to gjatë transportit apo magazinimit.	
Deklarata e produktit	EN 13956	
Defekte të dukshme	Kalon	(EN 1850-2)
Gjatësia	20.00 m (- 0 % / + 5 %)	(EN 1848-2)
Gjerësia	2.00 m (- 0.5 % / + 1 %)	(EN 1848-2)
Trashësia efektive	1.2 mm (- 5 % / + 10 %)	(EN 1849-2)
Drejtvijsia	≤ 30 mm	(EN 1848-2)
Rrafshësia	≤ 10 mm	(EN 1848-2)
Masa për njësi sipërfaqeje	1.5 kg/m ² (- 5 % / + 10 %)	(EN 1849-2)

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj goditjes	nënshtresë e fortë	≥ 450 mm	(EN 12691)
	nënshtresë e butë	≥ 800 mm	
Rezistenca ndaj ngarkesës statike	nënshtresë e butë	≥ 20 kg	(EN 12730)
	nënshtresë e fortë	≥ 20 kg	
Rezistenca ndaj depërtimit të rrënjëve	Kalon		(EN 13948)
Rezistenca ndaj tërheqjes	gjatësore (md) ¹⁾	≥ 9.0 N/mm ²	(EN 12311-2)
	tërthore (cmd) ²⁾	≥ 8.5 N/mm ²	
	¹⁾ md = machine direction ²⁾ cmd = cross machine direction		
Zgjatimi	gjatësor (md) ¹⁾	≥ 200 %	(EN 12311-2)
	tërthor (cmd) ²⁾	≥ 200 %	
	¹⁾ md = machine direction ²⁾ cmd = cross machine direction		
Qëndrueshmëria e përmasave	gjatësore (md) ¹⁾	≤ 0.3 %	(EN 1107-2)
	tërthore (cmd) ²⁾	≤ 0.3 %	
	¹⁾ md = machine direction ²⁾ cmd = cross machine direction		
Rezistenca e fugës ndaj prerjes	≥ 500 N/50mm		(EN 12317-2)
Palosja në temperatura të ulëta	≤ -25 °C		(EN 495-5)
Reagimi ndaj zjarrit	Kategoria E		(EN ISO 11925-2, klasifikim i EN 13501-1)
Ndikimi i kimikateve të lëngshme, përfshirë ujin	Me kërkesë		(EN 1847)
Rezistenca ndaj rrezatimit UV	Nuk është e aplikueshme për ekspozimin e përhershëm ndaj rrezatimit UV.		
Transmetimi i avujve të ujit	μ = 20 000		(EN 1931)
Papërshkueshmëria e ujit	Kalon		(EN 1928)

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit

Duhet të përdoren aksesorët e mëposhtëm:

- Sikaplan® D-18 membranë e papërforcuar për modifikimin e detajeve
- Sikaplan® S-15 membranë e papërforcuar për modifikimin e detajeve
- Sikaplan® SG-15 ose Sikaplan® G-15 membranë tarracash për lidhje dhe pjesë të ekspozuara ndaj rrezatimit UV
- Pjesë të formuara qoshesh, pjesë të posaçme të modifikuara për qoshet dhe hyrjet e tubave
- Sika-Trocal® Metal Sheet Type S
- Sika-Trocal® Cleaner-2000
- Sika-Trocal® Cleaner L-100
- Sika-Trocal® Welding Agent
- Sika-Trocal® Seam Sealant
- Sika-Trocal® C-733 (adeziv)

Kompatibiliteti

Nuk ka kompatibilitet gjatë kontaktit të drejtpërdrejtë me plastikat e tjera, p.sh. EPS, XPS, PUR, PIR, PF.
Nuk ka rezistencë ndaj katranit, bitumit, vajit dhe materialeve me përmbajtje tretësi.

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Temperatura e mjedisit

-15 °C min. / +60 °C max. për saldim me ajër të nxehtë
+5 °C min. / +60 °C max. për saldim me tretës

Temperatura e nënshtresës

-25 °C min. / +60 °C max. për saldim me ajër të nxehtë
+5 °C min. / +60 °C max. për saldim me tretës

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS

Sipërfaqja e nënshtresës duhet të jetë e njëtrajtshme, e lëmuar dhe pa pjesë të dala të mprehta, etj.
Sikaplan® SGmA-12 duhet të ndahet nga nënshtresat jokompatibël me anë të një shtresë ndarëse efikase për parandalimin e vjetërimit të përshpejtuar.

APLIKIMI

Punimet e instalimit duhet të kryhen vetëm nga kontraktorë të udhëzuar nga Sika për aplikime membranash.

Aplikimi i disa produkteve ndihmëse, p.sh. adezivë/hollues është i kufizuar për temperaturat mbi +5°C. Ju lutemi referohuni tek skedat teknike përkatëse. Për aplikime në temperaturë mjedisi nën +5°C, mund të jetë e detyrueshme marrja e masave të posaçme për shkak të kërkesave për siguri në përputhje me rregulloret kombëtare.

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Procedura e instalimit:

Sipas udhëzimeve të vlefshme të prodhuesit për vendosjen e Sikaplan® SGmA-12 për sistemin e tarracës me balast.

Metoda e fiksimit:

Shtirim i lirë dhe mbulim me balast. Fiksimit mekanik në perimetër të tarracës për të mbajtur në vend membranën.

Membrana e hidroizolimit të tarracës vendoset me shtirim të lirë dhe mbulohet me balast sipas gjendjes

lokale të ngarkesës së erës. Nëse pesha e balastit është pamjaftueshme për të ndaluar ngritjen e membranës nga era, membrana mund të fiksohet mekanikisht mbi mbivendosjen e tegelave ose pavarsisht këtyre.

Metoda e saldimit:

Tegelat e mbivendosjes saldohen me pajisje saldimit të nxehtë, si makineritë për saldim manual me ajër të nxehtë dhe rulat për presion ose makineritë për saldim automatik me ajër të nxehtë me kapacitet të kontrollueshëm të temperaturës ajri të nxehtë min. 600°C.

Lloji i rekomanduar i pajisjes:

- LEISTER TRIAC PID për saldim manual
 - LEISTER VARIMAT për saldim automatik
- Parametrat e saldimit përfshijnë temperaturën, shpejtësinë e makinerisë, rrjedhjen e ajrit, presionin dhe duhet të vlerësohen rregullimet e makinerisë, të adaptuara dhe të kontrolluara në kantier sipas llojit të pajisjes dhe gjendjes klimaterike përpara saldimit. Gjerësia efektive e mbivendosjeve të salduara duhet të jetë min. 20 mm.

Nëse kushtet lokale të motit lejojnë saldimit me tretës të mbivendosjeve me Sika-Trocal® Welding Agent, atëherë kjo lejohe për sistemin me balast Sikaplan® SGmA-12. Gjerësia efektive e mbivendosjes së salduar duhet të jetë 30 mm.

Tegelat duhet të testohen mekanikisht me kaçavidë për të siguruar integritetin / përfundimin e saldimit. Çdo parregullsi duhet të korrigojë me saldim me ajër të nxehtë.

Skajet e tegelave të salduara me tretës duhet të izolojnë me Sika-Trocal® Seam pas testimit.

KUFIZIME

Gjeografike / Klimaterike

Përdorimi i membranës Sikaplan® SGmA-12 kufizohet në zona gjeografike me temperaturë minimale mesatare mujore prej -25°C. Temperatura e përhershme e ambientit gjatë përdorimit kufizohet në +50°C.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Duhet të sigurohet ajrosje me ajër të freskët gjatë punimeve (saldimit) në dhoma të mbyllura.

RREGULLORJA (EC) NO 1907/2006 - REACH

Ky produkt është një objekt siç përcaktohet në nenin 3 të rregullores (KE) Nr. 1907/2006 (REACH). Nuk përmban substanca që mund të çlirohen nga objekti nën kushte përdorimi normale ose të parashikuara arsyeshëm. Nuk nevojitet fleta e të dhënave të sigurisë në zbatim të nenit 31 të së njëjtës rregulloreje për të sjellë produktin në treg, transportuar apo përdorur atë. Për përdorim të sigurt, ndiqni udhëzimet që jepen në këtë fletë me të dhënat e produktit. Duke u bazuar në njohuritë tona aktuale, ky produkt nuk përmban SVHC (substances of very high concern / substanca me rrezikshmëri të lartë) siç renditen në Aneksin XIV të rregullores REACH apo në listën e substancave kandidatë të publikuar nga Agjencia Europiane e Kimikateve në përqëndrime më të mëdha se 0.2% (për peshë).

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sikaplan® SGmA-12
Mars 2019, Botimi 02.02
020905031000121101

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

SikaplanSGmA-12-sq-AL-(03-2019)-2-2.pdf

